



**DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË  
SËMUNDJEVE INFEKTIVE**

**BULETINI MUJOR I  
SËMUNDSHMËRISË  
INFEKTIVE  
(Pasqyra 14 Sh)**

MARS, 2024

Buletini MuJOR i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin MuJOR bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin mars 2024 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH). Të dhënat e pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat e raportuara në SISI krahasohen nga DEKSI, dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP.

### **1. Sëmundjet diarreike**

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit mars 2024 zënë 20.4 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 144.5/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 3.0/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën

laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin mars 2024 në nivel kombëtar.

**Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin mars 2024  
(Incidenca raste/100.000 banorë)**


	Raste mars 2024	Incidenca mars 2024 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.03
Salmoneloza	26	0.91
Shigelozë (Disenteri bacilare)	14	0.5
Dizenteri amebike	0	0.0
Toksiko-infeksione alimentare	85	3.0
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	4010	140.1
Sëmundje diarreike në total	4136	144.5

## 2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

### 2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit mars 2024 janë raportuar në total 177 raste variçelë (incidenca 6.18/ 100.000 banorë ) nga të cilat, 66 raste janë të dyshuara dhe 111 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen varicelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 100 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 79 raste, grafiku 1.


**Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, mars 2024**



## 2.2 Fruthi

Gjatë muajit mars janë raportuar 27 raste si të dyshuar me fruth nga të cilët janë konfirmuar 2 (7.4%) raste nga ana laboratorike. Incidenca e sëmundjes për muajin mars është 0.07 raste/100 000 banorë.

**Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara me fruth dhe incidenca sipas muajve 2024**



Vërehet një trend në rënie në muajin mars të vitit 2024.

Të dy rastet e konfirmuara janë banorë të bashkisë Tiranë, nuk janë të shtruar në spital, i përkasin gjinisë femër. Rastet janë të grup-moshës pediatrike (1rast) 1 vjeç, i pavaksinuar dhe 1 rast adult (34 vjeç) i vaksinuar me dy dozat. Vaksinimi i rastit është verifikuar në të dhënat e kartelave të vaksinimit (SIV).

### 2.3 Pertusis


Në muajin mars janë raportuar 45 raste të konfirmuar me Pertusis nga NJVKSH Tiranë. Incidenca e Pertusis në muajin mars është 0.8 raste/100 000 banorë në vend. Moshë mediane e rasteve është 1.4 vjeç me IQR 0.3 – 10.1 vjeç. Nga shenjat klinike mbizotëron kollë e shpeshtë dhe me aksese mbytëse dhe temperaturë. Shumica e rasteve (84.6%) janë të vaksinuar sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit, dhe 8 raste janë vaksinuar me Heaxaxim. Të hospitalizuar janë 44% e rasteve të cilët janë konfirmuar me serologji. Për çdo rast është kryer hetimi epidemiologjik dhe evidentimi i kontakteve nga NJVKSH Tiranë. Dy raste kanë transmetim familjar, dy raste kanë transmetim në shkollë, ndërsa rastet e tjera kanë transmetim komunitar.

### 3. Hepatitet virale

#### Hepatit viral B (HBV)

Në muajin mars janë raportuar 5 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV-së në muajin shkurt është 0.2 raste/100 000 banorë në vend.

**Grafiku 3. Numri i rasteve të reja me HBV dhe incidencë (raste/100 000 banorë) sipas muajve**



Të gjitha rastet në muajin mars i përkasin grup-moshës adulte nga 39-56 vjeç, janë banorë nga bashkia Dibër (2), Durrës (2), Kuçovë (1) dhe kanë shfaqur shenja klinike të HBV-së.

## Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin mars është raportuar 1 rast i konfirmuar me HCV, mosha 46 vjeç, femër nga Dibra. Për rastin është kryer hetimi dhe është ndjekur nga mjekët specialistë.

Incidenca e HCV në nivel kombëtar për muajin mars është 0.04 raste/100 000 banorë.

## 4. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit mars 2024 janë raportuar gjithsej 14 raste, nga të cilat: 13 raste me tuberkuloz (TB) pulmonar dhe 1 rast ekstrapulmonar. Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv. 4 prej tyre janë recidive. Rastet pulmonare përkatësisht janë: 6 në Tiranë, 2 në Elbasan, 1 në Korçë dhe 1 në Kukës. Rasti ekstrapulmonar është versament pleurale në rrethin e Fierit.

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh, por në shtrirje rastet janë pothuasje në gjithë vendin.

## 5. Sëmundjet zoonotike

*Tabela 2: Shpërndarja e zoonozave në muajin mars 2024, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikecie)*

	Mars(raste 2024)	Incidenca (raste/100,000) 2024
Antraks (Plasje)	1	0.03
Brucelozë	5	0.17
Leptospirozë	0	0.0
Rikecie	1	0.03


Për muajin mars është raportuar 1 rast i konfirmuar me Antraks nga NJVKSH Gjirokastrë, 1 rast Rikecioze nga NJVKSH Elbasan, dhe 5 raste Brucelozë përkatësisht 2 nga NJVKSH Durrës, 1 nga NJVKSH Dibër, 1 nga NJVKSH Sarandë dhe 1 nga NJVKSH Tepelenë.

## 7 Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

### 7.1 COVID-19


Gjatë muajit mars 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 44 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin mars është 1.5 raste /100000 banorë.

**Grafiku 5. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave (mars 2024)**



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është ajo 65-74 vjeç me incidencë 2.9 raste për 100000 banorë, e ndjekur nga grup-mosha 55-64 vjeç me incidencë 2.3 raste për 100000 banorë.

**Grafiku 6. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive (mars 2024)**




Bashkitë me incidencë më të lartë janë Kolonja, Skrapari, Tirana etj.

Gjatë muajit mars 2024 është raportuar 1 rast i shtruar në spital dhe asnjë rast vdekje.

## 7.2 Grip

Gjatë muajit mars janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 125 raste të konfirmuara me grip, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin mars është 4.37 raste /100000 banorë. Grafiku 10 tregon shpërndarjen e rasteve sipas tipit të viruseve qarkullues. Vërehet mbizotërim i gripit tipi B.

**Grafiku 7. Tipi i viruseve qarkulluese**



Në muajin mars qarkullimi i gripit paraqet aktivitet sezonal normal të zakonshëm dhe të pritshëm për stinën. Raste me grip u identifikuan si nga survejanca sentinel ILI-SARI, ashtu edhe nga survejanca virologjike josentinel.